



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1044/5 prot.

Datë 28.04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 560/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “T & J Construction” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër”, me Nr. REF-78077-03-04-2026, me objekt: “Blerje Cakull”, me fond limit 1.666.665 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.03.2026 nga autoriteti kontrktor, Agjensia Sherbimevce Publike Rurale, Bashkia Elbasan

**Ankimues:** Operatori ekonomik “T & J Construction” SHPK me Nipt M29718101T dhe adresë: Lagjja Teqe, zk.2908, pasuria nr.7/90, Peqin

**Autoriteti Kontraktor:** Agjensia Sherbimevce Publike Rurale, Bashkia Elbasan  
Rruga Shkumbini, Elbasan

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05.03.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër”, me Nr. REF-78077-03-04-2026, me objekt: “Blerje Cakull”, me fond limit 1.666.665 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë

e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 18.03.2026 nga autoriteti kontrktor, Agjensia Sherbimeve Publike Rurale, Bashkia Elbasan

II.2. Në datën 18.03.2026, autoriteti kontrktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 25.03.2026, autoriteti kontrktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.“T&J CONSTRUCTION ” SHPK	1.333.376 lekë	s’kualifikuar
2.“ KUPA” SHPK	1.598.536 lekë	kualifikuar
3.“ M U R A T I” SHPK	1.589.445 lekë	s’kualifikuar
4.“ Genti 001” SHPK	1.492.472 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 03.04, autoriteti kontrktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontrktor është depozituar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6487, datë 07.04.2026 dhe me Nr. 1044/2026 Prot., datë 07.04.2026 e operatorit ekonomikë “T & J Construction” SHPK ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar me pretendimin si më poshtë:

*“Kerkojme te rivleresoni procedure e prokurimit pasi skualifikimi eshte bere ne kundërshtim me ligjin per prokurimin publik dhe aktet nenligjore. Pretendimet se nuk kemi ngarkuar ne SPE vertetimin per shlyerjen e taksave vendore nuk qendron pasi ligji dhe vkm ne fuqi kerkon qe ky kriter te deklarohet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit dhe jo te ngarkohet ne SPE.Neni 26 ,pika dh, vkm nr.285 date 19.05.2021 iPer miratimin e rregullave te prokurimit publik” eshte konceptuar si me poshte :*

*idh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;” Duhet te kuptoni se koncepti i taksës perfshin si taksat kombetare si dhe ato vendore dhe dispozita e mesiperme i perfshin te dyja keto taksa pa perjashtuar asnjeren .*

*Nisur nga sa parashtruar me siper ekrkojme rivleresimin e procedures dhe kualifikimin tone..”*

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1044/1 prot., datë 07.04.2026, me

arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “T & J Construction” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1044 prot, datë 07.04.2026.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 264/12 prot., datë 14.04.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1044/2 prot., datë 14.04.2026 me objekt “*Dërgohet vendimi shqyrtimit të ankesave*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzim të saj.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “T & J Construction” SHPK se: “*Nuk ka dorëzuar dokumentacion për të provuar përmbushjen e kriterit 2.2.2*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

*“2.2.2 Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifat vendore për kestat e maturuara vitin 2025 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifat vendore)”*.

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të të përzgjedhjes/kualifikimit”, pika dh) të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

*dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*

III.1.3. Në ankesën e paraqitur në Sistemin e Ankesave Elektronike, ankimuesi pretendon se: “[...] ligji dhe vkm ne fuqi kerkon qe ky kriter te deklarohet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit dhe jo te ngarkohet ne SPE.Neni 26 ,pika dh, vkm nr.285 date 19.05.2021 iPer miratimin e rregullave te prokurimit publik” eshte konceptuar si me poshte :

idh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;” Duhet te kuptoni se koncepti i taksës përfshin si taksat kombetare si dhe ato vendore dhe dispozita e mesiperme i përfshin te dyja keto taksa pa përjashtuar asnjeren. [...]”

III.1.4. Në përgjigjen e dhënë ankimuesit, KSHA i ka refuzuar pretendimet e këtij të fundit, duke argumentuar se: “[...] Në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Operatori Ekonomik "T&J Construction" sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë vertetim që dëshmon se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore.. në respektim të ligjit të prokurimit publik nr.162 Dt 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285 Dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 26 i vKM ka përcaktuar qartë përmbajtjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe formatin standart të tij. Sipas nenit 76/2 të LPP i referohet taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore të cilat janë të ndryshme nga ato të taksave vendore..... Ju bëjmë me dije gjithashtu se për kërkesat që Ak i konsideron të plotësuar me formularin përmbledhës e ka përcaktuar shprehimisht në dst: Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së ofertave sipas shtojcës 8. Ky përcaktim nuk është bërë në kriterin 2.2.2 i cili konsiderohet i përmbushur vetëm me dorëzimin e tij në sistem gjatë fazës së ankimimit....” ”

III.1.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK, ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku, në Pjesën II: “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit”, është deklaruar si vijon:

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

**Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Vertetim per pagim detyrime leshuar nga Drejtoria e Tatimeve DTM, Vertetim per pagim kontributet leshuar nga Drejtoria e Tatimeve DTM, Vertetim per pagim taksat dhe tarifat vendore leshuar nga institucioni perkates.**

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.7. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”..*

III.1.8. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

- “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*
- 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”.*

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

- “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”.*

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “ç” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.9. Neni 1 “Objekti i ligjit” të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, “Objekt i këtij ligji janë taksat e bashkive dhe të komunave”.

Neni 2 “Qëllimi i ligjit” të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, “Ky ligj përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre”.

Në pikën 7, të nenit 4 të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave,

në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar”.

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.12. Për sa i përket arsyes se skualifikimit të operatorit ekonomik, me pretendimin se “pasi nuk ka paraqitur “vërtetim për shlyerjen e taksave vendore”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se nga verifikimi i dokumentave të tenderit, rezulton se në shtojcën 8, janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim, nga ku nuk evidentohet të jetë përcaktuar që “dokumenti provues që provon likuidimin e detyrimeve tatimore dhe te taksave vendore të përmbushet me Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë ofertues

III.1.11. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK, Komisioni konstaton, se ky operator ekonomik ka ngarkuar në SPE shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, por mungon vërtetimi i lëshuar nga organet vendore për pagimin e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025, në kundërshtim me kërkesën e autoritetit kontraktor sipas të cilës operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes se “ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e Formularit të Përgjithshëm të Vetëdeklarimit, nëpërmjet të cilit, mes një mori vetëdeklarimesh është dhe vetëdeklarimi se ne: Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 7/2 të LPP-se”, bazuar në aktet ligjore për taksat dhe tarifave vendore, KPP sqaron se, Ligji Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në pikën 7, të nenit 4 të Ligjit Nr. 9632 datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin Nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Pra, administrimi dhe mbledhja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, është kompetencë e organeve të qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në këtë kuadër KPP gjykon, se përcaktimi i vërtetimit mbi shlyerjen e detyrimit të taksave dhe tarifave vendore me anë të formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 9 të dokumenteve standarde të tenderit, nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për më tepër, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e Përjashtimit A: “Deklarata për përmbushjen e kriteve të përgjithshme të kualifikimit” nga ankimuesi është deklaruar se autoriteti ose organin lëshues i vërtetimit është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kur referuar legjislacionit si më sipër cituar, vërtetimin e pagimit të detyrimeve të taksave dhe tatimeve vendore, e lëshojnë organet e qeverisjes vendore.

### **Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.**

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “T&J Construction” për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër”, me Nr. REF-78077-03-04-2026, me objekt: “Blerje Cakull”, me fond limit 1.666.665 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.03.2026 nga autoriteti kontrktor, Agjensia Sherbimeve Publike Rurale, Bashkia Elbasan.
2. Autoriteti kontrktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

